

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	Nr. Prot: Broj Prot:
Nr. i faqeve Br. stranica No pages	Data: Datum: Date:
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku
i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology

Kabineti i Ministririt/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Prishtinë, më 4 gusht 2015
Ref. nr: 232/018


Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në bazë të dispozitave të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), dispozitave të nenit 5 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta zyrtare, nr. 17, 16 shtator 2011) dhe dispozitave të nenit 8 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare, Nr. 1, 18 prill 2011), merr këtë:

V E N D I M

1. Të gjithë Pedagogët të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit Baçelor, me kohëzgjatje të studimeve tre (3) vjet dhe janë në marrëdhënie pune si edukatorë, mësues klase apo mësime të edukatës qytetare duhet të përfundojnë Programin për Avancimin e Pedagogëve që do të përmbajë lëndë pedagogjike dhe akademike me kohëzgjatje 1 vjeçare, përkatësisht, 60 ECTS kreditë.
2. Të gjithë Pedagogët të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit Baçelor, me kohëzgjatje të studimeve katër (4) vjet apo pesë (5) (MA) dhe janë në marrëdhënie pune si edukatorë, mësues klase apo mësime të edukatës qytetare duhet të përfundojnë Programin për Avancimin e Pedagogëve që do të përmbajë lëndë avancuese akademike, më së paku 30 ECTS kreditë.
3. Obligohet Departamenti për Politika të Arsimit Parauniversitar të siguroj listën me të dhënat e sakta të Pedagogëve, të përcaktuar në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi.

4. Për zbatimin e pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi, MASHT në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" do të përgatisin dhe organizojnë Programin për Avancimin e Pedagogëve.
 - 4.1. Përmbajtja akademike dhe profesionale, forma e organizimit, kushtet dhe afatet e realizimit të Programin për Avancimin e Pedagogëve do të përcaktohen nga Fakulteti i Edukimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina";
 - 4.2. Programi për Avancimin e Pedagogëve duhet të përfundoj më së largu deri më 31 dhjetor 2016;
5. Të gjithë Pedagogët e punësuar, të përcaktuar në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, e vazhdojnë punën me kusht që të aplikojnë dhe përfundojnë me sukses Programin për Avancimin e Pedagogëve, më së largu deri më 31 dhjetor 2016.
6. Obligohet Departamenti i Inspeksionit të Arsimit të zbatoj procedurat e licencimit të mësimdhënësve për të gjithë Pedagogët e përcaktuar në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, pas përfundimit me sukses të Programit për Avancimin e Pedagogëve dhe sipas legjislacionit në fuqi.
7. Ministri i MASHT do të themelojë një Komision të përbërë prej ekspertëve dhe palëve të përfshira për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij vendimi, i cili komision do t'i raportoj me shkrim Ministrin, çdo tre (3) muaj, për zbatimin e këtij vendimi.
8. Obligohet Departamenti për Politika të Arsimit Parauniversitar që të ua dërgojë këtë vendim të gjitha Drejtorie Komunale për Arsim.
9. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Prof. Dr. Arsim BAJRAMI, Ministër



pe

Iu dërgohet:

- Të gjitha Drejtorive Komunale për Arsim;
- Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"
- Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT;
- Departamentit të Inspeksionit të Arsimit, MASHT;
- Departamenti për Arsimin e Lartë, MASHT;
- Departamenti për Politika të Arsimit Parauniversitar;
- Arkivit të MASHT.